



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**

**Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

# **RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS**

**( prill 2019 – mars 2020)**

**DHE**

## **PLANI I PUNËS**

**(prill 2020 – mars 2021)**

Prishtinë, prill 2020

*FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OSK-SË*

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të OSK-së,

Kam nderin që të paraqes para juve raportin vjetor të punës për periudhën prill 2019 – mars 2020, sipas programit mandatues, të prezantuar në Mbledhjen Konstituive të Kuvendit të II-të të Odës së Stomatologëve të Kosovës, mbajtur me 20.03.2019. Një raport ky gjithpërfshirës, që përfshin zhvillimet më të rëndësishme në Odën e Stomatologëve të Kosovës duke përfshirë punën e të gjitha organeve të OSK-së.

Viti 2019, ka qene viti i fundit i mandatit katër vjeçar të Kuvendit të I-rë të OSK-së, gjithashtu vit zgjedhor ku të gjithë bashkërisht kemi qenë pjesë e zgjedhjeve të Kuvendit të sotëm.

Krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të OSK-së, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arritur që gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e OSK-së.

Prandaj, shfrytëzoj rastin që t'ju falenderoj për angazhimin, mbështetjen dhe përkrahjen të rezervë për funksionalizimin e Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Me respekt,

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës Prof. Dr. Blerim Kamberi

## PËRMBAJTJA

<i>Hyrje</i> .....	3
<i>Zgjedhja e organeve të OSK-së</i> .....	5
<i>Transparenca dhe llogaridhënia për punën e Odës, krijimi dhe ristrukturimi i faqes zyrtare të Odës</i> .....	7
<i>Krijimi i Data Bazës së të dhënave për stomatologët e vendit dhe publikimi i Regjistrit të anëtarëve të OSK-së</i> .....	7
<i>Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe Puna e organeve dhe komisioneve të përbërshme të Odës</i> .....	8
<i>Shërbimi Profesional</i> .....	8
<i>Regjistrimi, licencimi dhe rilicencimi i stomatologëve</i> .....	9
<i>Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)</i> .....	10
<i>Çështjet etike</i> .....	13
<i>Solidariteti dhe ndihma reciproke</i> .....	14
<i>Bashkëpunimi ndërkombëtar</i> .....	14
<i>Memorandumet e bashkëpunimit</i> .....	18
<i>Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës</i> .....	22
<i>Raportimi i Monitorimit dhe Vlerësimit të Indikatorëve 3.2 dhe 3.2.3</i> .....	25
<i>Donacionet</i> .....	25
<i>Raporti i pasqyrave financiare</i> .....	26
<i>Plan veprimi për periudhën prill 2020 – mars 2021</i> .....	31

## HYRJE

Oda e Stomatologëve të Kosovës në përputhje me mandatin e saj ligjor të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OSK-së, si dhe planit vjetor të punës, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë periudhës prill 2019 – mars 2020. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara që njëherit kanë qenë të përfshira në planin vjetor të punës së OSK-së.

Në vijim janë paraqitur objektivat dhe veprimet specifike të cilat kanë qenë të planifikuara për periudhën prill 2019 – mars 2020.

- Zgjedhja e organeve të OSK-së,
- Transparenca dhe llogaridhënia për punën e Odës,
- Krijimi dhe ristrukturimi i faqes zyrtare të Odës,
- Krijimi i bazës së të dhënave për stomatologët e vendit,
- Publikimi i Regjistrit të anëtarëve të OSK-së,
- Rishikimi i kompatibilitetit funksional të infrastrukturës ligjore të OSK
- Nxjerrja e Rregulloreve që rregullojnë veprimtarinë dhe funksionalizimin e Odës:
  - Rregullorja për procedurat e vendimmarrjes të organeve të Odës;
  - Rregullore për regjistrim, licencim/rilicencim të stomatologëve,
  - Rregullore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional,
  - Rregullore për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike;
  - Rregullore për fushëveprimin dhe kompetencat e Komisionit për çështje etike;
  - Rregullore për solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së,
  - Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës për Shërbimin Profesional të Odës,
  - Rregullorja për menaxhimin e financave të OSK-së,
  - Rregullorja për procedurat e prokurimit;
  - Rregullorja për udhëtime zyrtare,
  - Vendim për caktimin e lartësisë së taksave administrative të OSK-së

- Puna e organeve dhe komisioneve të përhershme të Odës,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK-së,
- Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës
- Kyçja aktive dhe kontributi në realizimin e projektit të ndërtimit të ndërtesës për Odat e profesionistëve shëndetësor,
- Marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoriatin Shëndetësor të MSH,
- Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën për të drejtat e pacientëve,
- Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Mjekëve të Kosovës,
- Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Infermierëve të Kosovës,
- Marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë e produkteve dhe pajisjeve stomatologjike,
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë dhe rajonal. me odat përkatëse,
- Bashkëpunimi me FDI dhe ERO,
- Donacionet.

## 1. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË OSK-SË

Më 23 Prill 2019 u mbajt mbledhja e rregullt e Kuvendit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në të cilën u bë zgjedhja e nënkryetarëve të OSK-së, anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës.

- Nënkryetarë të OSK-së u zgjodhën: Dr. Ali Gashi, Dr. Kastriot Meqa dhe Dr. Petrit Loci.
- Për anëtarë të Këshillit Drejtues nga radha e anëtarëve të Kuvendit u zgjodhën: Dr. Musa Qazimi, Dr. Nijazi Heta, Dr. Fatmir Gërdellaj, Suzana Ismeti dhe Oruç Karadolam. Kryetari i OSK-së, Prof. Dr. Blerim Kamberi dhe nënkryetarët Dr. Ali Gashi dhe Dr. Petrit Loci, janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
- Në Gjyqin e Nderit u zgjodhën: Dr. Hilmi Cakaj - kryetar Dr. Visar Bunjaku - zv. kryetar, Dr. Benein Sharapoll - anëtar, Dr. Flutura Jusufi - anëtare, dhe Dr. Teuta Kutllovci - anëtare.

Me 14 Maj 2019 u mbajt mbledhja e rregullt e Kuvendi të OSK-së në të cilën u bë zgjedhja e Këshillin Etik, Gjyqit të Nderit, Prokurori i Odës dhe zv. Prokurori, si dhe komisionet e përhershme.

- Në Këshillin Etik u zgjodhën: Dr. Ardian Nika - kryetar, Dr. Ali Prebreza – zv. kryetar, Dr. Zenel Ahmeti - anëtar dhe Dr. Drita Rama Durguti - anëtare.
- Në Gjyqin e Nderit u zgjodhën: Dr. Jemin Zeqiri - kryetar, Hasan Salihu - anëtar, Dr. Astrit Gojani - anëtar, dhe më dt. 21.12.2019 Dr. Zana Lila-Krasniqi - anëtare.
- Për Prokuror të OSK-së u zgjodh Prof. Asoc. Dr. Ferit Koçani, ndërsa për zv. Prokuror Dr. Yll Halimi.
- Në Komisionin Etik u zgjodhën: Dr. Zana Sllamniku - kryetare, Dr. Albert Dumani – zv. kryetar, Prof. Dr. Agim Islami - anëtar, Dr. Arlinda Dragusha - anëtare, Dr. Lulzim Kallaba - anëtar, dhe Dr. Valon Halili - anëtar.
- Në Komisionin për Buxhet dhe Financa u zgjodhën: Dr. Afrim Abazi - kryetar, Dr. Ilmi Kryeziu – zv. kryetar, Prof. Dr. Milaim Sejдини - anëtar, Dr. Besim Ademi - anëtar, Dr. Burhan Arifi - anëtar, Dr. Nora Aliu - anëtare dhe Dr. Tahir Luma - anëtar.
- Në Komisionin për Edukim të Vashdueshëm Profesional u zgjodhën: Dr. Ekrem Çitaku - kryetar, Dr. Hazir Osaj – zv. kryetar, Dr. Arianit Demiri - anëtar, Dr. Lendita Nallbani -

anëtare, Dr. Mustafa Kasa - anëtar, Prof. Ass. Dr. Teuta Pustina - anëtare dhe Dr. Lumturije Asllani - anëtare.

- Në Komisionin për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve u zgjodhën: Dr. Bylbyl Reçica - kryetar, Dr. Agron Vezgishi – zv. kryetar, Prof. Ass. Dr. Miranda Stavileci-Veliu - anëtare, Dr. Adnan Qarkagjija - anëtar, Dr. Qëndrim Alija - anëtar, Dr. Kreshnik Spahija - anëtar, dhe Dr. Fahri Shabani - anëtar.
- Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke u zgjodhën: Dr. Tefta Mjekiqi - kryetare, Dr. Leonora Sefa – zv. kryetare, Dr. Merita Kuqi - anëtare, Dr. Arjeta Gashi - anëtare, Dr. Bashkim Zuka - anëtar, Dr. Granit Kupina - anëtar, Dr. Nasuf Gërdellaj - anëtar.
- Në Komisionin për Edukim Specialistik u zgjodhën: Dr. Kastriot Meqa - kryetar, Dr. Lindita Ismaili-Guda – zv. kryetare, Dr. Afërdita Hoxha- Manxhuka - anëtare, Dr. Ali Tahiri - anëtar, Dr. Faton Loci - anëtar, Dr. Shaqir Miftari - anëtar dhe Dr. Xhevdet Aliu - anëtar.



Anëtarët e Kuvendit të OSK-së

## **2. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ODËS, KRIJIMI DHE RISTRUKTURIMI I FAQES ZYRTARE TË ODËS**

Ngritja e transparencës dhe llogaridhënia për punën e OSK-së që është çelësi për efikasitetin e udhëheqjes së suksesshme të Odës ka qenë një ndër objektivat kryesore, e bashkë me këtë edhe funksionalizimi i Web-faqes së Odës si mjet për realizimin e këtij objekti. **Me 19 Qershor 2019 është bërë edhe lansimi i web-faqes së OSK-së (<http://osk-ks.org/>).** Nga kjo datë e deri tani, në këtë web-faqe janë publikuar të gjitha informatat rreth punës së Odës, rregulloret, vendimet dhe çështjet tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta, që janë me rëndësi për komunitetin e stomatologëve të vendit. Këto publikime do të nxisin në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e Odës.

## **3. KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR STOMATOLOGËT E VENDIT DHE PUBLIKIMI I REGJISTRIT ZYRTAR TË ANËTARËVE TË OSK-SË**

Një prioritet i radhës ka qenë krijimi i bazës së të dhënave për stomatologët e Republikës së Kosovës. Pas krijimit të Databazës, me 23 Gusht 2019 është publikuar për herë të parë Regjistri i anëtarësisë në web-faqen zyrtare të Odës. Ky regjistër tani përditësohet për çdo muaj.

Oda vazhdimisht ka bërë fushatë publike për detyrimin e anëtarësimit të stomatologëve në OSK, në bazë të Ligjit të Profesionistëve Shëndetësor që e garanton anëtarësimin e detyrueshëm.

Në këtë periudhë, OSK-ja ka filluar për herë të parë printimin dhe shpërndarjen e kartelave të anëtarësisë.

Deri në ditën e raportimit të punës sonë njëvjeçare, Oda e Stomatologëve numëron **1578 stomatolog me licencë valide të punës.**



#### 4. KOMPLETIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE DHE PUNA E ORGANEVE DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

Gjatë vitit 2019 Kuvendi i OSK-së ka mbajtur tri mbledhje të rregullta me dt. 23 prill 2019, 14 maj 2019 dhe 21 dhjetor 2019, me ç'rast janë miratuar vendime dhe rregullore nga fusha e veprimtarisë së Odës, e më këto është funksionalizuar edhe puna e organeve dhe komisioneve të përhershme si dhe është kompletuar infrastruktura ligjore e Odës.

Fillimisht, Këshilli Drejtues me autorizim të Kuvendit të dt.14.05.2019, ka nxjerrur të gjitha Rregulloret e përkohshme për ta kompletuar infrastrukturën ligjore të OSK-së, dhe për ta funksionalizuar veprimtarinë e saj deri në miratim të tyre nga ana e Kuvendit. Kuvendi i OSK-së në mbledhjen e rregullt të dt. 21 dhjetor 2019, ka miratuar këto rregullore në vijim (Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit të Kuvendit të OSK-së, të dt. 21 Dhjetor 2019):

- Rregullore për procedurat e vendimmarrjes të organeve të Odës;
- Rregullore për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike;
- Rregullore për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të stomatologëve;
- Rregullore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional
- Rregullore për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike;
- Rregullorja për menaxhimin e financave të OSK-së;
- Rregullorja për procedurat e prokurimit;
- Rregullorja për udhëtime zyrtare;
- Vendim për caktimin e lartësisë së taksave administrative në OSK.

#### 5. SHËRBIMI PROFESIONAL

Pas miratimit të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës për Shërbimin Profesional të Odës nga Këshilli Drejtues, janë rekrutuar me kontratë të rregullt 2 zyrtare administrative. Me aprovimin e Këshillit Drejtues për shërbime të caktuara ligjore është i angazhuar një ekspert ligjor. Është bërë riorganizimi i librave të protokoleve të OSK-së. Poashtu, është bërë harmonizimi i pagave për Shërbimin Profesional të Odës.


Po ashtu kemi instaluar pakon softuerike Pro-Data Finance që mundëson regjistrimin e të gjitha infomatave financiare dhe nxjerrjen e shpejtë dhe të saktë të raporeteve dhe pasqyrave financiare.


## 6. REGJISTRIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Komisioni për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve ka kryer procedurat ligjore të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve.

Gjatë periudhës 1 Prill 2019 – 31 Mars 2020 janë:

- a. Të anëtarësuar 402 stomatolog,
- b. Të licencuar 186 stomatolog (licencim Doktor i Stomatologjisë 147, licencim specialistik 39),
- c. Të rilicencuar 155 stomatolog (rilicencim Doktor i Stomatologjisë 112, rilicencim specialistik 43).





## 7. EDUKIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë kësaj periudhe ka akredituar aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional, si vijon:

1. Brainstorm Organisation (Konferencë), Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore 6, 9-11.05.2019
2. Qendra e Dhembit Qeshu (Kurs) , Implantologjia Digjitale, 3-4.05.2019
3. NLP ALLIANZ (Kurs – Punim aktiv), “Çdo gjë që kishit dëshirë të dini për mbushjet nga kompoziti”, 17.04.2019
4. NTSH Koslabor (Konferencë), MIS Day Kosovo, 11.05.2019
5. Oda e Stomatologe/ EVP QKMF – Gjakovë, Ligjëratë profesionale në kuadër të EVP-së, Ligjëratë profesionale në kuadër të EVP-së, 06.12.2019.
6. Renew Kosovo L.i.c (Kurs), Trajnimi i implantologjisë, 12-13.07.2019
7. N.T.SH.M LETAMED (Kurs), trajnim për Laser Dentar, 30.06.2019
8. CC DENTAL SHPK (Kurs), Trajnim i avancuar në Implantologji, 20-21.09.2019 (Nr. prot. 32 dt 26.07.2019).
9. NekiDent (Kurs), Trajnim një ditore me Dr. Dario Novak (DMG), 28.09.2019 (Nr. prot. 49 dt 03.09.2019).
10. UBT (Konferencë), Konferenca ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore, 16-27.10.2019 (Nr.prot.77 dt 23.10.2019).

11. Renew Kosovo L.i.c ( Kurs), Trajnim i avancuar në Implantologji, 15-16.11.2019 (Nr. prot. 78 dt 23.10.2019).
12. Shoqata Kombetare Shqiptare (Konferencë), Zhvillimet bashkëkohore në fushën e dentistrisë dhe shëndetit oral, 15-16.11.2019 (Nr. prot.79 dt 23.10.2019).
13. Oda e Stomatologëve të Kosovës (Konferencë), Konferenca e IV stomatologjike me pjesëmarrje ndërkombëtare " Stomatologjia sot dhe nesër", 22-23.11.2019 (Nr. prot. 87 dt 08.11.2019).
14. Shoqata Dentare Shqiptare (Konferencë), Konferenca e 25-të Kombëtare Dentare & Takimi i 5-të i Ortodontëve Shqiptar , 6-7.12.2019 (Nr. 83 dt 06.11.2019).
15. NLP ALLIANZ (Kurs), Çdo gjë që kishit dëshirë të dini për mbushjet nga kompoziti, 22.11.2019 (Nr. prot. 84 dt 06.11.2019).
16. NLP ALLIANZ (Kurs), Përparimi dhe cementimi i restaurimeve pa përmbajtje metali, 22.11.2019 ((Nr. prot. 84 ddt 06.11.2019).
17. DENTAL DAY (Work Shop), Konferenca e IV ndërkombëtare, 22-23.11.2019 (Nr. prot. 86 dt 08.11.2019).
18. Oda e Stomatologeve/ EVP QKMF – Ferizaj, Ligjërata profesionale në kuadër të EVP-së, Ligjërata profesionale në kuadër të EVP-së, 06.12.2019 (Nr.prot.50 dt 03.09.2019).
19. Neki-Dent, Kurs, "Suksesi me sistemin-tomas&amda i bërë me Dentaurem" 28-29.02.2020 (Nr.prot. 106 dt.10.01.2020).
20. Anka Internacional LLC, Kurs, "Aplikimet radiologjike në praktikën stomatologjike" 29.02.2020 (Nr.prot. 101 dt.09.01.2020).
21. NLP ALLIANZ, Kurs, Workshop në Ortodoncinë fikse "Trajnimi i klasës II/I dento-alveolare " pjesa praktike në tyodont, 12-13.03.2020 (Nr.prot. 125 dt.19.02.2020).

Në periudhën raportuese KEVP ka lëshuar 128 Certifikata/vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarëve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, ndërsa 5 raste janë refuzuar për mungesë të pikëve kredituese jot ë mjaftueshme.

### 7.1 Emërimi i koordinatorëve rajonalë për EVP

Për t'i përmbushur nevojat e profesionistëve shëndetësorë në plotësimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre profesionale, Këshilli Drejtues me dt. 10.09.2019 ka emëruar koordinatorët bashkëpunues për EVP në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë), të cilët kanë për detyrë të hartojnë planin vjetor të ligjëratave në QKMF në kuadër të EVP-së.

Komisioni për EVP ka miratuar planin vjetor të programit të ligjëratave për vitin 2020 (18 ligjërata nga ekspert të fushave të ndryshme të stomatologjisë) nëpër Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare.

### 7.2 Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike

Oda e Stomatologëve të Kosovës ka organizuar Konferencën e Katërt Stomatologjike, me datë 22 dhe 23 Nëntor 2019 në Prishtinë. Në këtë Konferencë përveç stomatologëve kanë marr pjesë edhe teknikët dentarë dhe infermieret e stomatologjisë. Konferenca ka përfshirë 9 ligjerata me ligërues vendorë dhe ndërkombëtarë nga Italia, Kroacia dhe Maqedonia Veriore, tri kurse trajnimi, shkëmbim të eksperiencave studimore praktike dhe teorike në të gjitha disiplinat stomatologjike. Në kuadër të konferencës është mbajtur edhe ekspozita dentare, ku kompanitë e ndryshme dentare ofruan produkte dhe pajisje stomatologjike bashkëkohore.



Pamje nga Konferenca e Katërt Stomatologjike, 22-23 Nëntor 2019

## 8. ÇËSHTJET ETIKE

Në periudhën raportuese janë shqyrtuar tri raste për pretendim të shkeljes etike, prej të cilave njëri është refuzuar për shkak të kalimit të afatit për incimin e procedurës pas skadimit të një (1) viti nga data e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të Odës, konform Nenit 27 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë. Rasti i dytë është hudhur nga Prokurori, sepse nuk ka ekzistuar dyshim i bazuar se është bërë shkelje etike. Dhe në rastin e tretë, nga Gjyqi i Nderit është shqiptuar masa disiplinore “kërkim falje ndaj pacientit me shkrim”, pasi vetë pala e kishte pranuar shkeljen.

## 9. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Është hapur nënlogaria e Odës së Stomatologëve të Kosovës për Fondin e Solidaritetit për anëtarët e saj, me qëllim të grumbullimit të mjeteve financiare për anëtarët e OSK-së, për rastet e parapara sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli Drejtues menjëherë ka marrë vendim për alokimin e mjeteve prej llogarisë kryesore të OSK-së në nënlogarinë për Fondin e Solidaritetit në shumë prej 2.000 euro, si dhe me dt. 21.01.2020 po ashtu në shumë prej 2.000 euro. Me vendim të Këshillit Drejtues me nr. 1093 të dt.29.01.2020 të gjitha mjetet e grumbulluara nga gjobat e shqiptuara paguhen në xhirlogarinë e Fondit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke.

Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke gjatë periudhës raportuese janë paraqitur dy raste që kanë kërkuar mbështetje financiare për shkaqe shëndetësore.

## 10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

### 10.1 Pjesëmarrja në aktivitetet e FDI, 4-8 Shtator 2019, San Francisko, SHBA

Në cilësinë e zyrtarit të OSK-së për ndërlidhje me Federatën Ndërkombëtare Stomatologjike (FDI), Dr. Kastriot Meqa ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga organet e FDI, për detyrat që u takojnë anëtarëve të rregullt të kësaj organizate. Po ashtu, me autorizimin e Kryetarit të OSK-së, ka marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FDI.

Në lidhje me aktivitetet e zyrtarëve të ndërlidhjes, kanë qenë të organizuara tri takime. Në njërin prej tyre ka qenë takimi informues për Ditën Botërore të Shëndetit Oral (World Oral Health Day) që tradicionalisht mbahet me 20 Mars të çdo viti. Motoja e vitit 2020 do të jetë “Thuaj Ahh: Bashkohuni për Shëndetin e Gojës” (“Say Ahh: Unite for Mouth Health”)

Në Asamblenë e Përgjithshme të FDI, ka marrë pjesë në mbledhjen e datës 7 Shtator 2019, ku janë diskutuar çështjet e riorganizimit dhe plotësimit të vendeve të lira në komisionet e FDI.



Pjesëmarrja në aktivitet e FDI

## 10.2 Pritja e delegacioneve të odave të stomatologëve të Kroacisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë nga kryetari i OSK-së

Me 22 Nëntor 2019 me ftesën tonë për një vizitë pune ishte delegacioni i Odës së Stomatologëve të Kroacisë, në krye me Kryetarin e saj Dr. Hrvoje Pezo. Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe shumë miqësore në ambientet ku u mbajt Konferenca e Katërt Stomatologjike. U bisedua për proceset në të cilat është duke kaluar OSK-ja, me tema kyçe të cilat kanë të bëjnë me organizimin e saj, proceset e anëtarësimit, licencimit e me theks të veçantë në format e edukimit të vazhdueshëm profesional. Po ashtu u kërkua nga homologu që të ofrojë ndihmën në anëtarësimin e OSK-së në organizata ndërkombëtare, dhe konkretizimin e bashkëpunimit të dy odave përmes një mermorandumi.





Nga takimi me delegacionin e Odës së Stomatologëve të Kroacisë

Kemi pritur në një takim tjetër edhe Kryetarin e Këshillit Drejtues të Odës së Stomatologëve të Maqedonisë së Veriut, Dr. Mirlind Selimi me ç'rast u bisedua për çështjet që janë në interes të përbashkët për të dy odat. Njëherit, Dr. Selimi e ftoi zyrtarisht kryetarin Kamberi për një vizitë pune në Odën e Stomatologëve të Maqedonisë së Veriut.



Nga takimi me përfaqësuesin e Odës së Stomatologëve të Maqedonisë së Veriut

Poashtu në kuadër të Konferencës u realizua takimi me Dr. Erion Cerekja, përfaqësues i Urdhërit të Stomatologut të Shqipërisë. U dakordua që të zhvillohet një takim zyrtar në nivel të dy delegacioneve përkatëse me qëllim të harmonizimit të çështjeve me interes të përbashkët.

### 10.3 Vizita e kryetarit dhe nëkryetarit të OSK-së në Odën e Stomatologëve të Maqedonisë

Me dt. 26 Shkurt 2020 në Shkup të Maqedonisë Veriore, kemi realizuar takimin zyrtar me homologët nga Oda e Stomatologëve të Maqedonisë Veriore. Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe shumë miqësore në ambientet e Odës së Stomatologëve të Maqedonisë. Në këtë takim u nënshkrua edhe Marrëveshja e bashkëpunimit, ku të dy palët shprehën vullnetin e tyre për bashkëpunim të qëndrueshëm me interes bilateral, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit dentar.




Nga takimi në Odën e Stomatologëve të Maqedonisë

## 11. MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT

### 11.1 Memorandumi me Odën e Mjekëve të Kosovës

Me 16 maj 2019 është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit ndërmjet Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Odës së Stomatologëve të Kosovës. Kemi shprehur vullnetin e përbashkët për bashkëpunim të qëndrueshëm sipas fushave përkatëse, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor.



Memorandumi me Odën e Mjekëve të Kosovës

### 11.2 Memorandumi me Odën e Infermierëve të Kosovës

Me 22 Maj 2019 është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit ndërmjet Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe Odës së Infermierëve të Kosovës. Jemi dakorduar për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të infermierëve dhe teknikëve dentarë nëpërmjet formave të edukimit të vazhdueshëm profesional.



Memorandumi me Odën e Infermierëve të Kosovës

### 11.3 Memorandumi me kompaninë dentare “Allianz”

Me 12 Qershor.2019 është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe kompanisë dentare “Allianz”. Me këtë Memorandum jemi dakorduar të bashkëpunojmë për të nxitur dhe mbështetur organizimin e aktiviteteve të ndryshme stomatologjike në përputhje me nevojat dhe kërkesat profesionale të stomatologëve, infermierëve dhe teknikëve dentarë.



Memorandumi me kompaninë dentare “Allianz”

#### 11.4 Memorandum me Shoqatën për të Drejtat e Pacientëve të Kosovës

Me 25 Korrik 2019 është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve të Kosovës. Kemi shprehur vullnetin për bashkëpunim të ndërsjellët për të siguruar avancimin e raporteve në mes të stomatologëve, si profesionistë shëndetësorë dhe pacientëve, si shfrytëzues të shërbimeve stomatologjike.



Memorandumi me Shoqatën për të Drejtat e Pacientëve të Kosovës

#### 11.4 Memorandum me kompaninë dentare SH. P. K. “Dental Day”

Me datën 21 Gusht 2019 është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me kompaninë SH.P.K. “Dental Day”. Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e informatave dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me organizimin e trajnimeve,, promovim e produkteve inovative në fushën e stomatologjisë, mbështetje në organizimin e panairove dhe aktiviteteve të ndryshme promovuese në fushëveprimtarinë e palëve.



Memorandumi me kompaninë dentare SH. P. K. “Dental Day”

#### **11.5 Odat e profesionistëve shëndetësor me kontratë të përbashkët për zbatim-projekti të ndërtimit të objektit të përbashkët**

Odat e profesionistëve shëndetësor kanë nënshkruar një kontratë të përbashkët mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e objektit të përbashkët për nevojat e ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve publike të përcaktuara me Ligj. Ky objekt do të jetë i projektuar për të siguruar një sipërfaqe të mjaftueshme për nevojat e tyre. Ndërtimi i objektit pritet të zbatohet në kuadër të projektit të LUX DEV – Agjencisë për Bashkëpunim të Luksemburgut dhe nëpërmjet projektit “Health Support Programme in Kosovo Phase II”. Kontrata është nënshkruar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, Oda e Stomatologëve të Kosovës, Oda e Infermierëve të Kosovës, Oda e Farmacistëve të Kosovës dhe Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës.



Nga takimi i përbashkët i odave të profesionistëve shëndetësorë

## **12. MBROJTJA E INTERESAVE PROFESIONALE, KONSULTA, INFORMACIONE DHE SHËRBIME TË TJERA PËR ANËTARËT E ODËS**

### **12.1 Mbështetja e specialistëve të papunë**

Oda e Stomatologëve të Kosovës do të vazhdojë të japë kontributin e saj për të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së stomatologut dhe sektorit të shëndetësisë në përgjithësi.

Kemi ngritur shqetësimin e një numri të konsiderueshëm të specialistëve të fushave të ndryshme të stomatologjisë të cilët janë në pritje të punësimit të tyre në institucionet publike një kohë të gjatë. Për këtë ne kemi drejtuar një shkresë MSH ku kemi shfaqur brengën e tyre. Kontributi i OSK ka qenë shumë domethënës në këtë proces dhe Ministria e Shëndetësisë e ka mirëpritur këtë gatishmëri për të ciën gjë edhe ka ndërrmarë të gjitha masat që kjo të ketë qëndrueshmëri.



Nga takimi me specialistët e papunësuar

## 12.2 Kërkesa për ekuivalentim të stomatologëve në specializim në kategorinë H7

Kemi adresuar kërkesën me 29.11.2019 institucioneve relevante për ekuivalentim të stomatologëve në specializim në kategorinë H7.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin për pagat në sektorin publik nr. 06/L-111., i cili në kategorizimin e pagave merret parasysh parimi i barazisë i vendosur tashmë në ligjin për pagat (Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 3) sipas të cilit “secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme”

Bazuar në Ligjin e aprovuar 06/L-111 kategorizimi i stomatologëve në specializim nuk figuron në kategorinë H7, ku në këtë kategori janë mjekët në specializim, pra është një gabim teknik, këto kaetgori janë të profilit të njëjtë profesional.

Prandaj duke pasur parasysh këtë, bazuar në Ligjin e aprovuar 06/L-111 në nenin 32 të këtij ligji jemi drejtuar institucioneve relevante me kërkesë që të bëhet ekuivalentimi i stomatologëve me pozitën H7 në të cilën mungojnë stomatologët në specializim.



### **12.3 Kërkesa për zbatimin e ligjit për respektimin e rrezikshmërisë në punë drejtuar përmes njoftimit në media**

Përmes një njoftimi për media, me dt. 24 Janar 2020, kemi kërkuar zbatimin e ligjit për respektimin e rrezikshmërisë në punë, zbatimin e plotë të Ligjit të Punës dhe respektimin e Kontratës Kolektive që përcakton saktësisht deri në 30 orë punë brenda javës dhe 30 ditë pushim vjetor. Po ashtu kemi kërkuar, ashtu siç është e cekur në Kontratën Kolektive Sektoriale, Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si dhe Udhëzimi Administrativ, të respektohet edhe rrezikshmëria në punë e stomatologëve.

Mosrespektimi i këtyre dispozitave ligjore dhe mosplotësimi i kushteve të punës është ndër shkaktarët i cili po ndikon në migrimin e profesionistëve shëndetësorë jashtë Republikës së Kosovës. Prandaj kemi kërkuar nga institucionet shëndetësore, institucionet kompetente të nivelit qendror dhe atij lokal, që të trajtojnë me seriozitet më të madh kërkesat e komunitetit të stomatologëve për plotësimin e këtyre kushteve.

### **12.4 Komentet e përbashkëta me OMK dhe OFK lidhur me projekt-Udhëzimin për shkollim specialistik**

Kemi ngritur shqetësimin e përbashkët për mospërfshirjen dhe anashkalimin e rolit të odave në këtë proces si dhe kemi dhënë propozimin konkret se si e shohim zgjidhjen e këtij problemi, sepse edhe Ligji për Shëndetësi dhe Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë qartë kanë përcaktuar rolin e odave në edukimin specialistik të profesionistëve shëndetësorë.

### **12.5 Rekomandimet për profesionistët shëndetësorë të sistemit publik dhe privat të kujdesit dentar me rastin e pandemisë së COVID-19**

Me rastin e paraqitjes së pandemisë COVID-19, kemi reaguar konform kompetencave dhe përgjegjësisë. Fillimisht kemi bërë thirrje për të gjithë personelin shëndetësor të kujdesit dentar, të punësuar në sektorin publik dhe privat, që të shtojnë masat mbrojtëse gjatë punës me pacientë, veçanërisht masat në lidhje me mbrojtjen personale të personelit shëndetësor dhe ndihmës, si dhe në shtimin e masave për dezinfektimin e ambienteve dhe pajisjeve të punës. Në ndërkohë me evaluimin epidemiologjik kemi dhënë rekomandimet e duhura për profesionistët shëndetësor të

kujdesit dentar si dhe i kemi njoftuar në vazhdimësi për masat e përgjithshme që ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës.

### **13. RAPORTIMI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË INDIKATORËVE 3.2 DHE 3.2.3**

Oda e Stomatologëve të Kosovës në baza vjetore raporton indikatorët e përcaktuar në bazë të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë (2017-2021) pranë Divizionit për Monitorim dhe Vlerësim në Ministrinë e Shëndetësisë. Të dhënat e krahasuara të këtyre indikatorëve paraqiten me vlerën të ndryshme me 73% në vitin 2018 kurse me 93% në vitin 2019. Bazuar në matricën e SSSH-së 2017-2021, vlera aktuale prej 93% në vitin 2019 na paraqitet në pragun e performancës së dëshirueshme. Sipas trendit mund të themi se vlera finale në fund të implementimit të SSSH-së në vitin 2021 mund të jetë në mbi 93.3 % e që do të paraqet një performancë shumë të kënaqshme.

### **14. DONACIONET**

Donacionet dhe sponsorimet janë burim i rëndësishëm mbështetës në zgjidhjen e problemeve në shumë fusha të interesit, e sidomos janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare të Odës.

Për periudhën prill 2019 - mars 2020, OSK-ja ka pranuar këto donacione:

- Pranimi i donacionit nga LuxDev. në vlerë prej 1000 Euro për nevojat e zyrave të Odës,
- Pranimi i donacionit për Web faqe nga LuxDev. në vlerë prej 2000 Euro,
- Pranimi i donacionit të apartatit fotokopjues nga kompania “Astronik” Prishtinë, në vlerë prej 1000 euro.

## 15. RAPORTI I PASQYRAVE FINANCIARE

Raportet financiare janë e dhënë e mirë në vlerësimin e punës, dhe publikimet e tyre paraqesin transparencë të shpenzimit të parasë.

Tabelat me poshtë paraqesin pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të Odës, për periudhën 01 prill 2019 – 31.mars 2020. Në kategorinë e të hyrave (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) gjithsejt kanë qenë **111,485.21€**, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) janë shpenzuar gjithsejt **99,422.42 €**

**RAPORT I PËRGJITHSHËM FINANCIAR**  
**PERIUDHA RAPORTUESE: 01.04.2019 – 31.03.2020**

**I. TË HYRAT**

**1 - NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE**

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1-TM4
1.1.	Të hyrat nga anëtarimi	6,085.00	8,375.00	3,900.00	7,650.00	26,010.00 €
1.2.	Të hyrat nga licencimi/rilicencimi	7,700.00	9,440.00	6,780.00	6,740.00	30,660.00 €
1.3.	Të hyrat nga konferenca	-	-	39,452.00	-	39,452.00 €
1.4.	Të hyrat nga EVP	2,261.00	1,895.00	1,582.00	1,815.00	7,553.00 €
1.5.	Të hyrat nga Kodi Etik	180.00	120.00	215.00	210.00	725.00 €
1.6.	Të hyrat nga gjobat	-	-	205.00	50.00	255.00 €
1.7.	Të hyrat nga taksa për regjistrim dhe valorizim	-	520.00	530.00	645.00	1,695.00 €
1.8.	Të hyrat tjera (kthim i saldos)	-	-	365,63	61.18	426.81 €
<b>GJITHSEJ</b>						<b>106,776.81 €</b>

**2 - NË NËNLLOGARINË BANKARE TË FONDIT PËR SOLIDARITET**

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1:TM4
1.1.	Të hyrat nga llogaria kryesore e OSK-së në nënllogarinë e Fondit për Solidaritet	-	2,000.00	-	2,000.00	4,000.00 €
1.2.	Donacion-mëditjet nga mbledhja e Këshillit Drejtues të OSK-së	-	-	213.75	-	213.75 €
1.3.	Donacion-mëditjet nga mbledhja e Komisionit për Solidaritet të OSK-së	-	-	149.65	-	149.65 €
1.4.	Të hyrat nga pagesat e gjobave (nga dt. 21.01.2020)	-	-	-	345.00	345.00 €
<b>GJITHSEJ</b>						<b>4,708.40 €</b>

Total i të hyrave: Llogaria kryesore + llogaria e Solidaritetit (1+2)	111,485.21€
---	-------------

**I. SHPENZIMET****1 - SHPENZIMET NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE**

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIMET TM1-TM4
2.1	Shpenzimet për paga dhe mëditje	14,961.81	10,849.36	20,161.48	11,819.16	57,791.81€
2.2	Tatimet për paga dhe mëditje	1,867.93	1,245.74	1,173.65	1,552.77	5,840.09 €
2.3	Kontribute pensionale	1,605.68	1,021.58	1,427.78	1,856.10	5,911.14 €
2.4	Konferenca e OSK-së	-	-	12,509.71	-	12,509.71 €
2.5	Kuvendet dhe Këshilli Drejtues	654.70	-	1,762.00	-	2,416.70 €
2.6	Transfer në llogarinë e Fondit për Solidaritetit	-	2,000.00	-	2,000.00	4,000.00 €
2.7	Pajisje dhe inventar	583.00	207.00	810.00	1,042.50	2,642.50 €
2.8	Anëtarësisë në FDI dhe ERO	416.48	500.00	-	-	916.48 €
2.9	Përfaqësimi i OSK në Kongresin e FDI	-	-	648.94	-	648.94 €
3.0	Administrative/Operacionale të zyres: materiale pune për zyre	529.70	495.17	567.17	401.75	1,993.79 €
3.1	Reprezentacion për KD dhe komisioneve të përhershme, telefon dhe internet, derivate, taxi )	622.17	574.14	756.88	202.17	2,155.36 €
3.2	Provizione bankare dhe kthime tjera (Koslabor etj)	240.10	159.00	632.00	153.00	1,184.10 €
<b>GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë kryesore të OSK-së</b>						<b>98,010.62 €</b>

**2 - SHPENZIMET NË LLOGARINË E FONDIT PËR SOLIDARITET**

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIMET TM1:TM4
2.1.	Përkrahje financiare për trajtim mjekësor për anëtarët e OSK-së (2x700 euro)	-	-	-	1,400.00	1,400.00 €
2.2.	Provizione bankare	-	5.00	3.00	3.80	11.80 €
<b>GJITHSEJ</b>						<b>1,411.80 €</b>

<b>Total i Shpenzimeve:</b>	<b>99,422.42 €</b>
-----------------------------	--------------------

## Llogaria kryesore + llogaria e Solidaritetit (1+2)

1 – <u>Llogaria kryesore bankare e OSK-së</u>	2- <u>Nënllogaria e Fondit për Solidaritet</u>
SALDO ME DATË 01.04.2019.....51,414.57€	SALDO ME DATË: 20.09.2019.....0.00€
GJITHSEJ TË HYRAT..... <b>106,776.81€</b>	GJITHSEJ TË HYRAT ..... <b>4,708.40€</b>
GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....158,191.38€	GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....4,708.40€
GJITHSEJ SHPENZIMET.....(98,010.62€)	GJITHSEJ SHPENZIMET.....(1,411.80€)
SALDO ME DATË 31.03.2020.....60,180.76€	SALDO ME DATË:31.03.2020.....3,296.60€
1-Gjithsej të hyrat..... <b>106,776.81€</b>	1-Gjithsej të hyrat..... <b>4,708.40€</b>
2-Gjithsej Shpenzimet.....(98,010.62€)	2-Gjithsej Shpenzimet.....(1,411.80€)
<b>3-Bilanc pozitiv financiar.....8,766.19€</b>	<b>3-Bilanc pozitiv financiar.....3,296.60€</b>

**RAPORTI NË MES TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR DY LLOGARITË  
BANKARE PËR PERIUDHËN 01.04.2019 – 31.03.2020:**

1 - Të Hyrat gjithsej (1 + 1 ).....	<b>111,485.21€</b>
2 - Shpenzimet gjithsej (2 + 2) .....	<b>99,422.42€</b>
3 - Bilanc pozitiv financiar (3 + 3).....	<b>12,062.79€</b>



**PLAN VEPRIMI I PUNËS PËR PERIU DHËN****prill 2020 – mars 2021**

Plani vjetor i punës për prill 2020 – mars 2021 përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur synimet dhe objektivat strategjike të OSK-së. Ky plan është përpiluar në bazë të objektivave të përcaktuara nga Kryetari dhe Këshilli Drejtues dhe të bazuara në programin për vitet 2019-2023.

**Në këtë plan janë specifikuar aktivitetet kryesore:**

- Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
- Asistenca në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e kapacitetit të EVP-së dhe në regjistrimin, licencimin/rilicencimin e stomatologëve,
- Analizimi i akteve juridike të Kuvendit mbi nevojën e plotësimit ndryshimit të tyre,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
- Publikimi i Regjistrimit të licencave të stomatologëve të lëshuara nga OSK,
- Lëshimi i faksimilave unik për stomatologët e licencuar,
- Lobimi mbi kalimi e kompetencave për praktikën profesionale dhe edukimin specialistik nga Ministria e Shëndetësisë të Oda,
- Organizimi i Konferencës vjetore stomatologjike me pjesëmarrje ndërkombëtare,
- Realizimi i programit të ligjeratave në 7 (shtatë) QKMF në kuadër të EVP-së,
- Vazhdimësia e publikimit dhe azhurimit të listës zyrtare të anëtarëve të OSK-së,
- Mbështetja e vazhdueshme ndaj anëtarëve të saj në të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së stomatologut dhe prezantimit të interesave të tyre profesionale,



- Organizimi i sondazheve dhe aktiviteteve hulumtuese me qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit të stomatologëve si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
- Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë dhe rajonal. me odat përkatëse,
- Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO)
- Bashkëpunimi me ambasadat dhe zyrat e misioneve të ndryshme në vend si dhe me donatorët,
- Auditimi financiar për vitin 2017, 2018 dhe 2019.